



## Shtojca 7

### FTESË PËR OFERTË

**Emri:** OQJ RINIA E PAVARUR  
**Adresa:** (Shtepia e kultures"Hasan Prishtina")  
**E-mail:** [Riniavaparur@gmail.com](mailto:Riniavaparur@gmail.com)  
**Afati i dorëzimit të ofertës:** 30.01.2024-16.02.2024

OJQ Rinia e Pavarur po zbaton projektin "Lideret e Rinje dhe Lidershipi Modern" në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur komunat në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti, organizata "Rinia e Pavarur" hap thirrje me qëllim të kontraktimit të hapësirës për zbatimin e projektit, kontraktimit të ushqimit për pjesëmarrësit, si dhe printimit të materialeve të nevojshme të specifikuara në tabelën e mëposhtme.

#### Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më 16.02.2024, në adresën e e-mailit: [riniaepavarur@gmail.com](mailto:riniaepavarur@gmail.com)

#### Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Lideret e Rinje dhe Lidershipi Modern do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktet dhe shërbimet sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

| Nr | Përshkrimi i mallit/ shërbimit/      | Çmimi/njësi |
|----|--------------------------------------|-------------|
|    | <b>Lot I</b>                         |             |
| 1  | Kontraktim për Sallë për 70 Persona  |             |
| 2  | Ushqim për Pjesëmarrësit për 3 Ditë  |             |
| 3  | Organizimi i Tryezës së Rrumbullakët |             |
|    | <b>Lot II</b>                        |             |

|   |   |  |
|---|---|--|
| 1 | Printimi i Fletorreve A5, Bexhaat, Certifikatave, Kimikave ( 65 copa) |  |
|   | <b>Lot III</b>  |  |
| 1 | Realizimi dhe montazhimi i vidoes së projektit                        |  |

### Specifikime te pergjithshme teknike:

Aktiviteti parashikohet të fillojë më datën 29 Shkurt dhe të vazhdojë edhe në datat 1 dhe 2 Mars. Gjithashtu, duhet të përfshihet furnizimi me pije ujë dhe kafe gjatë ditëve të trajnimit në pozicionin e dytë.

Tek loti II kanë të drejtë të aplikojnë kompanitë të cilat në aktivitetin e tyre kanë shërbimet e dizajnit dhe printimit.

### Kushte të përgjithshme:

- 1) Subjektet duhet të jenë të regjistruar dhe licensuar rregullisht me objekt veprimtarie shërbimet e kërkuara;
- 2) Preferohen subjekte të regjistruar me aktivitet në territorin e komunes Skenderajit
- 3) Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email në adresën e organizatës [riniaepavarur@gmail.com](mailto:riniaepavarur@gmail.com) brenda datës 30.01.2024-16.02.2024 deri në orën 23.59, **Nuk pranoen ofertat dorazi.**
- 4) PAGESA e subjektit kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në EUR dhe të mos përfshihet TVSH-ja, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) Licencën për ushtrimin e aktivitetit / Ekstraktin e marre deri nje dite para postimit te ofertes;
- 2) Ofertën financiare për çdo produkt sipas tabelës më sipër.
- 3) Numrin e llogarisë bankare.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

Ky projekt mbështetet nga:  
**#ReLOaD**  
Programi Rajonal mbi Demokracinë  
Vendore në Ballkanin Perëndimor

